



Prof. Dr. Neyyir Tuncay Eren  
Kardiokirurg  
Spitali Amerikan 2 - Tiranë

Insulti shpeshherë vjen si pasojë e ndalimit të qarkullimit të gjakut në një nga zonat e trurit e cila shkaktohet nga mpiksja e gjakut në sistemin vaskular që ushqen trurin ose si pasojë e bllokimit me pjesën e pllakës së ateromit. Truri është një organ shumë i ndjeshëm ndaj qarkullimit të gjakut. Brenda disa minutave mund të dalin në pah dëmtimet e tij si rezultat i dëmtimit të qarkullimit të gjakut në tru. Një ndjeshmëri e tillë tregon për një sistem vaskular të pasur. Nga djathtas majtas, nga para mbrapa janë 4 vena të ndryshme që bashkohen në pjesën e sipërme dhe duke u lidhur me njëra-tjetrën krijojnë një rrjet. Në këtë rrjet që ndryshe quhet dhe poligoni Uillis, venat bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe përpriqen që të pengojnë dëmtimin e mëtejshëm të trurit. Një pjesë e rëndësishme e trurit furnizohet me gjak nëpërmjet arterieve të karotidit që shkojnë lart nga të dyja anët në pjesën përpara qafës. Ndërkohë që seksioni i arterieve vertebrale ushqen një pjesë më të vogël të trurit, truri i vogël (cerebellum) ushqehet nga arteriet vertebrale. Një shkak tjetër i rëndësishëm i insulit është edhe hemorragjia cerebrale. Por do të përqendrohemi më tepër tek problemet e enëve të gjakut.

Sipas studimeve, në Amerikë insulti cerebral zë vendin e 3- të si një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë. Prej kësaj sëmundjeje në këtë vend humbasin jetën mesatarisht 160.000 persona çdo vit. Që nga koha që kemi filluar punën tonë në Shqipëri, duke u nisur nga pacientët që kanë ardhur tek ne, mund të themi që në Shqipëri është një nga problemet kryesore të vdekshmërisë. Sipas parashikimeve tona, në Shqipëri humbasin jetën përafërsisht 2000 persona çdo vit. Kurse rreth 2500 persona megjithëse kanë kaluar një goditje cerebrale vazhdojnë jetën e tyre. Megjithatë, në një shumicë të konsiderueshme të këtyre rasteve shfaqen pasoja. Disa nga pasojat më të rëndësishme janë çrregullimet e lëvizjes, çrregullimet e së folurit dhe të kuptuarit. Pavarësisht se pacienti mbijeton, ai ka nevojë për një kujdes të vazhdueshëm, gjë që ul cilësinë e jetës. Mendoj se në Shqipëri janë rreth 30.000 njerëz që përpriqen të jetojnë me pasojat e kësaj insulite. Insulti është shpesh një problem që godet popullsinë e moshuar. Në moshat midis 65-75 vjeç kjo sëmundje vërehet në 8 persona nga 1000, kurse në moshat mbi 75 vjeç ky raport shkon deri në 18 persona.

# E shtuna Vital

nga  Spitali Amerikan  
Tiranë

## INSULTI CEREBRAL

### NJË PROBLEM VASKULAR I RËNDËSISHËM NË SHQIPËRI

Insulti cerebral ndodh kur një enë gjaku që mban oksigjen dhe lëndë ushqyese për trurin bllokohet nga një fluks apo mpiksje gjaku, duke mosfurnizuar trurin me oksigjen. Nëse privohen nga oksigjeni qoftë edhe për një periudhë të shkurtër kohe, qelizat nervore të trurit vdesin. Si pasojë e kësaj, pjesa e trupit që kontrollohet nga zona e prekur e trurit dëmtohet duke shkaktuar insulitn e cila prek lëvizjen e gjymtyrëve apo shikimin.

#### Përhapja e insulitit cerebral:

- Insulti cerebral është shkaku i tretë kryesor i vdekjes në Shtetet e Bashkuara, pas presionit të lartë të gjakut dhe kancerit
- Çdo 45 sekonda një person në Shtetet e Bashkuara pëson një insult cerebral
- Çdo tre minuta dikush vdes nga një insult cerebral

#### Insulti cerebral ishemi

Janë goditjet e shkaktuara nga mpiksjet e gjakut që bllokohen arterien. Ky është lloji më i zakonshëm, që përbën 70-80 për qind të të gjitha insulteve cerebrale.

#### Insulti cerebral hemorragjik

Kur këputet një enë gjaku, kjo shkakton gjakderdhje ose hemorragji. Pasi qelizat e trurit vdesin nga mungesa e oksigjenit, pjesa e trupit që kontrollohet nga ajo pjesë e trurit dëmtohet. Insulitet mund të shkaktojnë insulitn në aftësitë lëvizëse ose vështirësi në shikim.

#### "Mini - Insulte"

Ka edhe "mini-insulte" të njohura si insulte të përkohshme ishemi. Njerëzit të cilët kanë një sëmundje ishemi ka të ngjarë që të kenë edhe një tjetër. Këto insulte shkaktajnë simptoma të shkurtra goditjeje që përkeqësohen pas pak minutash ose orësh. Njerëzit shpesh i injorojnë këto simptoma, por ato janë një shenjë për paralajmërim të hershëm dhe 35% e atyre që përjetojnë një insult cerebral do të kenë përkeqësim të shpejtë nëse dëmi nuk trajtohet.

#### Simptomat e insulitit cerebral

- Mpirje ose humbje të ndjeshmërisë në fytyrë, krahë ose këmbë, veçanërisht në njërin anë të trupit
- Probleme në të folur ose në të kuptuar
- Probleme në shikim, duke përfshirë shikimin e plotë ose të pjesshëm, në një ose të dy sytë.
- Probleme në ecje, humbje të ekuilibrit.
- Dhimbje koke pa ndonjë shkak të përcaktuar.

Nëse ju shfaqen ndonjë nga këto simptoma, edhe në qoftë se ato zhduken shpejt, kërkoni ndihmë të menjëhershme mjekësore. Ndonëse të uritur për oksigjen, indet e trurit nuk vdesin menjëherë pas një insulit cerebral. Nëse enët e gjakut të bllokuara mund të hapen brenda tre deri në gjashtë orëve, mundësitë për t'u shëruar ekzistojnë.

#### Faktorët e rrezikut

- Obeziteti, presioni dhe kolesterolit i lartë i gjakut rrit rrezikun. Këta faktorë mund të reduktohen në masë të madhe nëpërmjet një stili jetese të shëndetshme ose trajtimi mjekësor.



- Tensioni i lartë i gjakut ushtron presion mbi arteriet, duke i bërë ato më të ndjeshme ndaj këputjeve dhe më shumë të prirura për të formuar mpiksjet, e cila mund të bllokohet arterien.
- Kolesterolit i lartë mund të çojë në bllokimin e arterieve karotide që marrin gjak nga qafa në tru. Një pjesë e kësaj mpiksjeje mund ta ndërpresë qarkullimin e gjakut dhe të shkojë për në tru, duke shkaktuar një insult cerebral.
- Fijëzimi i patrajtuar atrial shkakton rrahje në mënyrë të parregullt në zemër, e cila lejon grumbullimin dhe mpiksjet e gjakut. Nëse një mpiksje shpërthen jashtë dhe hyn në qarkullimin e gjakut në tru, ndodh një insult cerebral.
- Drepanocitoza i bën qelizat e kuqe të gjakut më pak të afta për të mbajtur gjakun në indet dhe organet e trupit, si dhe që të rrinë në muret e enëve të gjakut. Këto qeliza mund të bllokohen arteriet e trurit, duke shkaktuar një insult.
- Historia gjenetike familjare
- Pirja e duhanit

#### Disa nga masat për të parandaluar mundësinë e një insulit cerebral:

- Ndalo pirjen e duhanit
- Kontrollim të presionit të lartë të gjakut
- Ulja e nivelit të kolesterolit
- Mbajtja e një peshe të shëndetshme
- Shfrytëzimi i medikamenteve të përshtatshme si aspirina
- Trajtimi i sëmundjes së arterieve karotide

Një pacient, i cili ka kaluar një insult, pasi t'i vihet diagnoza nga ana klinike dhe radiologjike, duhet të përcaktohet shkaku. Nëse mendohet se ka ardhur nga një bllokim i enëve të gjakut, duhet bërë një ekzaminim sa më shpejt me USG Doppler të karotideve dhe arterieve vertebrale. Në shumicën e rasteve janë arteriet karotide. Ngushtime të rëndësishme që pengojnë qarkullimin e gjakut ose pllakat ulceroze në këtë zonë mund të krijojnë insult. Një tjetër faktor i rëndësishëm është zemra. Për arsye të ndryshme mund të krijojnë mpiksje gjaku (trombo) në zemër dhe copëzat që shpëputen nga këto

mpiksje gjaku mund të shkaktojnë emboli (bllokime) në tru. Në të dyja rastet duhet ndërhyrë tek pacienti. Mpiksjet e gjakut që kanë ndodhur brenda në zemër që shkaktajnë këto bllokime, shpeshherë mund të hiqen nëpërmjet kirurgjisë.

I gjithë synimi jonë është të mbrojmë njerëzit nga insulti, duke e diagnostikuar dhe trajtuar sëmundjen para se personi të kalojë insult. Më e rëndësishmja është se njerëzit duhet të jenë më vigjilent dhe të vlerësojnë veten e tyre. Faktorët më të rrezikshëm janë pirja e duhanit, hipertensioni, kolesterolit i lartë, përdorimi i alkoolit në mënyrë të tepruar, sëmundjet ekzistuese koronare të zemrës dhe diabeti. Individët që mbartin një ose më shumë nga faktorët e rrezikshëm duhet të bëjnë kontrolle. Përveç këtyre, disa nga shenjat që tregojnë për një insult të mundshme janë çrregullimet në ekuilibër, humbje të lehta ndjenjash, errësimi i syve, anomalitë motorike të herë pas hershme, mpirja e fytyrës, vështirësi në të folur ku këto vlerësohen si sëmundje ishemi (TIA). Kështu pra, personat që kanë kaluar një TIA pa humbur kohë duhet të bëjnë një kontroll tek mjeku. Metoda më e zakonshme e trajtimit tek pacientët që kanë ngushtime të rëndësishme në arteriet karotide ose pllaka ulceroze është gërryerja e omplagines në mënyrë kirurgjikale për pastrimin e brendshëm të venës dhe shpeshherë nëpërmjet një pjese të venës safenoze bëhet zgjerimi në formë arne. Në disa raste të përzgjedhura dhe të përshtatshme përdorim stendë. Veçse stendat e vendosura në arteriet karotide nuk janë aq të suksesshme dhe afatgjatë, po aq sa tek venat koronare ose venat e mëdha periferike. Por në rastet specifike kemi arritur në rezultate të mira.

 Spitali Amerikan

TIRANË / LAPRAKË +355 42 35 75 35 URGJENCË  
TIRANË / RR. DJBRËS +355 42 36 66 63  
FIER +355 34 23 21 23  
DURRËS +355 52 22 23 33

www.spitaliamerikan.com